



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 27
Prishtinë, më 5 tetor 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Qeraniq, Valon Ramadani, Avdullah Hoti, Emilija Rexhepi, Albert Kinolli dhe Ali Lajçi.

Munguan: Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Etem Arifi dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rrustemi.

Të ftuar: 1. Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës;
2. Emin Sylejmani, u. d. i kryeshefit ekzekutiv të Stacionit të Autobusëve- Prishtinë SH.A

Pjesëmarrësit tjerë: Argjend Zejnaj, MI; Senver Morina, Enver Boqolli, Arvita Zyferi dhe Vlora Spanca, ZKA; Vatra Qehaja, LVV.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 1.10.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Stacionit të Autobusëve Sh. A. Prishtinë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për sezonin e auditimit 2018-2019;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1.10.2018

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 1.10.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Avdullah Hoti, tha se ky është auditim i rregullsisë, me opinion të kualifikuar, me theksim të çështjes dhe theksimi i çështjes ka ndodhur, sepse për mirëmbajtjen e rrugëve janë buxhetuar nga kategoria e investimeve kapitale. Auditori ka gjetur se te pagat dhe menaxhimi i personelit, ka vazhduar mbajtja e pozitive me ushtrues detyre. Te prokurimi, është keq-klasifikimi i shpenzimeve dhe ka mangësi tek afatet dhe pranimet e punëve. Te mallrat dhe shërbimet, ajo që është problematike është përsëritja e procedurave me vlera të vogla. Një problem tjetër, është menaxhimi i projekteve kapitale me komunat. Problem edhe më i madh është hyrja në obligime buxhetore, pa mbulesë. Ai tha se gjatë vitit 2017, janë rritur edhe borxhet dhe kjo është sfidë për ministrinë. Më tej, theksoi se ka vërejtur që rekomandimet, në masë të madhe, janë plotësuar.

Pal Lekaj, tha se nuk është i kënaqur me menaxhimin e që e ka gjetur dhe se nuk ka ndonjë argument të fuqishëm që t'i kundërshtojmë të gjeturat e auditimit. Ai tha se ka përgatitur planin e veprimit për t'i adresuar dhe përmirësuar rekomandimet e auditorit. Më tej, theksoi se është e vërtetë që ka probleme me pagat. Ai tha se ekzistojnë mbi 30 punëtorë serbë që paguhen dhe nuk vijnë fare në punë, në ministri. Kjo është marrëveshje e nënshkruar në Bruksel dhe ne nuk mund të bëjmë më shumë në këtë çështje. Sa i përket Bechel Enka-s, tha se obligimet kontraktuale që i kemi si shtet, ne duhet t'i përmbushim.

Më tej, theksoi se ajo që është gjetur në vitin 2017, do të mundohet ta përmirësojë, dhe në vitin e ardhshëm, raporti të vijë me një opinion edhe më të mirë.

Avdullah Hoti, tha se shteti i Kosovës ka marrë obligime në Bruksel, për t'i punësuar ata punëtorë të komunitetit serb, mirëpo ju bëni shkelje ligjore, nëse vazhdoni t'i paguani, nëse ata nuk vijnë në punë. Ai pyeti ministrin se si i ka menduar 53 milionë €, për të paguar Bechel-Enka, meqenëse nuk ka asnjë mbulesë buxhetore gjatë vitit 2018?

Driton Selmanaj, pyeti ministrin se sa është numri i saktë i këtyre punëtorëve që nuk vijnë në punë nga komuniteti serb dhe nëse mund t'i sillni komisionit të dhënat e sakta për pozitat e tyre se çka punojnë, sepse këto po shihet qartë se janë veprime të kundërligjshme. Ai tha se, siç po shihet, kjo është dukuri edhe në institucionet tjera dhe nuk është vetëm në Ministrinë e Infrastrukturës.

Emilija Rexhpi, tha se Marrëveshja e Brukselit ka paraparë që të punësohen zyrtarë të komunitetit serb në institucione dhe mendoj se në Kosovë ka edhe komunitete tjera, jo vetëm komuniteti serb. Ajo tha se qëllimi i kësaj marrëveshjeje ishte që ky komunitet të integrohet në institucione. Tani po del që Ministria e Infrastrukturës paguan mbi 30 të punësuar, për të cilët për një pjesë të tyre nuk dihet se edhe çka punojnë dhe nuk dalin fare në punë. Në përgjithësi, nëpër institucione, ky numër është i lartë.

Besnik Osmani, theksoi se janë rreth 480 persona të punësuar që derivojnë nga Marrëveshja e Brukselit, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ata janë të punësuar si shërbyes civilë në 63 institucione të ndryshme. Sipas tij, rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit do ta ndihmojnë ministrin dhe Ministrinë e Infrastrukturës, që ta kenë në vëmendje këtë kategori. Ai tha se si auditor i Përgjithshëm nuk e sheh këtë problem në pikëpamje etnike, por në pikëpamje financiare. Më tej, theksoi se një pjesë e këtij stafi janë duke e kryer punën e tyre edhe janë shumë aktivë. Lidhur me opinionin e raportit, ai tha se ka qenë një gabim elementar, i cili ka ndikuar në dhënien e opinionit. Ministria ka pranuar zyrtarisht se merr të hyra nga AKP-ja, kur dihet se ne kemi një llogari unike të thesarit dhe përmes Kuvendit shpërndahen te ministrinë.

Ali Lajçi, tha se kjo është një praktikë gjeneruese, e cila tregon për një arbitraritet dhe mosllogaridhënie të institucioneve tona. Më tej, theksoi se nuk mund të themi se ky është një veprim politik dhe të bëjmë veprime antiligjore. Ai, gjithashtu, tha se rasti i 53 milionë eurove nuk ka qenë në domenin e ministrit, që të marrë një vendim “ad-hoc”, mirëpo është dashur të trajtohet sipas procedurave.

Albet Kinolli përgëzoi ministrin për sinqeritetin dhe tha se çështja e punëtorëve ka qenë një fshehtësi publike, që të gjithë e kanë ditur. Po ashtu, tha se nga komuniteti rom nuk ka asnjë punëtor që është në marrëdhënie pune dhe që nuk shkon në vendin e punës. Ai tha se janë për diskriminimin pozitiv, por jo vetëm të një komuniteti të caktuar. Lidhur me raportin, ai pyeti ministrin: Si ka ndodhur një lëshim i tillë për vlerësimin e pasurive për mosformim të komisionit, që ka ndikuar në dhënien e opinionit?

Emilija Rexhpi, theksoi se mos të mbetet kjo se vetëm 30 të punësuar nga komuniteti serb janë të punësuar në Ministri të Infrastrukturës, por ekzistojnë në shumë institucione të punësuar të këtij komuniteti e që në fakt nuk dihet se çka punojnë, por kjo për herë të parë është paraqitur në raportin e auditimit të PVF-ve për vitin 2017, në MI.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i auditimit për PVF të MI-së për vitin 2017, të mos adresohet për në seancë plenare. Megjithatë, Ministria e Infrastrukturës të dorëzojë raport me shkrim, lidhur me numrin e të punësuarve të minoritetit serb, si dhe numrin e atyre që nuk kanë respektuar orarin e punës, të përcaktuara me rregullat e shërbimit civil.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Stacionit të Autobusëve Sh. A. Prishtinë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Valon Ramadani, tha se auditori ka dhënë opinion të kualifikuar në raportin e auditimit të Stacionit të Autobusëve, me komentin se pasqyrat financiare vjetore për vitin 2017, përveç mosvlerësimit të pasurisë jo qarkulluese, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale. Ai tha se auditori ka identifikuar shumë çështje të tjera, që duhet adresuar si: planifikimi i dobët i të hyrave dhe shpenzimeve në planin e biznesit 2017-2019, ku planifikimi i shpenzimeve të përgjithshme të ndërmarrjes ishte më i lartë sesa të hyrat, mospërputhshmëria mes kuponëve fiskalë të regjistruar nga arka fiskale dhe Z-raporteve të dorëzuara në arkën administrative për të hyrat e shitjes së biletave; vendimi i kryeshefit Ekzekutiv për t'i shtuar dy të hyra të reja, që nuk ishin të përfshira në rregulloren e Bordit, blerja e mallrave dhe shërbimeve, pa procedura të prokurimit, humbjet e bartura vit pas viti, si dhe ka një zbatim të ulët të rekomandimeve nga viti paraprak dhe vitet e mëhershme.

Emin Sylejmani, tha se ka lexuar raportin e auditorit dhe të gjitha të gjeturat e paraqitura, qëndrojnë. Sa i përket vlerësimit të aseteve, pas luftimeve, ne kemi bërë një vlerësim të aseteve. Ai tha se i di standardet se si e kërkojnë të bëhet vlerësimi, por që kapacitetet i kanë të tilla. Te plani i biznesit, ai tha se ka qenë një kryeshef tjetër, i cili nuk ka qenë profesional dhe plani nuk ishte bërë në harmoni me të hyrat. Lidhur me punësimet, tha se në vitin 2017 kishin ndodhur punësimet enorme dhe këtë vit nuk kanë pasur punësime, përveç një punëtori të sigurimit, për shkak të kërcënimeve që ai personalisht kishte pasur. Ai, gjithashtu, shtoi se auditorja e brendshme ka qenë një punëtore e papërgatitur profesionalisht, e cila nuk ka marrë masat e nevojshme rreth auditimit të brendshëm.

Driton Selmanaj, pyeti z. Sylejmani: Që sa kohë është në këtë pozitë? Më tej, tha se nga sqarimet që po jepni, po del që këtu mungon truri menaxherial. Ai tha se shumë procedura të prokurimit nuk janë zhvilluar në përputhje me ligjin. Të gjithë jemi të obliguar që ta zbatojmë ligjin. Po ashtu, tha se raporti do sqarime dhe e gjithë kjo nuk është vetëm shkak i mungesës së dijeve.

Valon Ramadani propozoi që pa prezencën e kryesuesit të Bordit, të mos vazhdohet më tutje diskutimi për këtë raport.

Përfundim

KMFP vendosi që në mbledhjen e radhës të ftohet kryesuesi i Bordit të Ndërmarrjes Stacioni i Autobusëve Sh. A. Prishtinë, për të diskutuar për raportin e auditimit të PVF-ve të ndërmarrjes.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për sezonin e auditimit 2018-2019

Besnik Osmani, tha se ajo që ndryshon prej viteve të kaluara, është se kemi tri ministri të reja që janë shtuar. Njëra është MAPL, për shkak se ka kaluar afati lidhur me konfliktin e interesit. Është rritur numri i auditimeve nga projektet e jashtme, po ashtu edhe numri i auditimeve të performancës, është rritur. Në total janë 136 auditime të planifikuara. Kapacitetet tona, nga viti i kaluar, kanë dallim me vetëm 5 auditorë më shumë. Ai tha se kanë lënë dy auditime të zbrazëta dhe në bashkëpunim me deputetët do t'i plotësojnë.

Driton Selmanaj, tha se në vitin e kaluar patëm shtuar dy kërkesa, njërin lidhur me subvencionet në bujqësi dhe e dyta me kontratën e KEDS-it. Lidhur me kontratën e KEDS-it, Prokuroria ka filluar një

proces dhe ne jemi dakorduar që derisa të përfundojë procesi në Prokurori, të mos vazhdojmë me auditimin. Ai tha se plani është përgatitur mirë dhe i pranueshëm, mirëpo nëse komisioni ka kërkesa për auditime shtesë, atëherë mund ta bëjmë në mbledhjen e radhës së komisionit.

Përfundim

KMFP shqyrtoi planin e punës së ZKA-së për sezonin e auditimit 2018 -2019 dhe kërkesat për ndryshim të tij mund të bëhen deri në mbledhjen e radhës së komisionit.

6. Të ndryshme

Driton Selmanaj i njoftoi deputetët, që më datë 10 tetor 2018, do të mbajnë punëtori të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, të cilën do ta mbështesë GIZ-i, në të cilën do të trajtojnë raportin vjetor të auditimit për vitin 2017.

Përfundim

KMFP vendoi që komisioni të mbajë punëtori të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, më datën 10 tetor 2018.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj